



Aktenzeichen: 254.00-923/16/2

Datum/Unser Zeichen: 15. Juli 2022 / sem-blc

Informacion i shkurtër mbi mbledhjen e Taksës së Veçantë mbi Pasuritë

Azilkërkuesit, Personat e pranuar përkohësisht dhe Personat që kanë nevojë për mbrojtje pa leje qëndrimi i nënshtrohen Taksës së Veçantë mbi Pasuritë, duke u bazuar në Nenin 86 të Ligjit për Azilin.

Taksa e Veçantë mbi mjetet pasurore vendoset duke ju marrë mjetet pasurore. Për këtë qëllim, Policia, Autoritetet Doganore dhe Autoritetet e tjera mund të konfiskojnë përkohësisht pasurinë e personave që i nënshtrohen kësaj Takse të Veçantë. Pasuritë e marra përkohësisht do t'i kalojnë Sekretariatit Shtetëror për Migracionin. Sekretariati Shtetëror për Migracionin vendos me një vendim të posaçëm për marrjen përfundimtare të këtyre mjeteve pasurore në bazë të Taksës së Veçantë mbi pasurinë.

Personat që i nënshtrohen kësaj Takse të Veçantë duhet të dëshmojnë prejardhjen e pasurive të tyre.

Nëse vërtetohet se mjetet pasurore i kanë nga paga e tyre për punën që ata kanë bërë ose ato pasuri rrjedhin nga ndihma sociale apo emergjente, ato do t'i kthehen të plota personit që i janë marrë.

Nëse prejardhja ligjore e pasurive të tjera mund të vërtetohet, atëherë do ju mirren përfundimisht vetëm mjetet pasurore që tejkalojnë shumën prej 1000.-- CHF (Neni 16 Paragrafi 4, Rregullorja për Azilin 2).

Nëse prejardhja ligjore e pasurive që u janë marrë këtyre personave nuk mund të vërtetohet, atëherë ato do t'ju mirren atyre në tërësi.

Nëse personi i cili i nënshtrohet Taksës së Veçantë brenda afatit kohor prej shtatë muajve nga paraqitja e Kërkesës për Azil ose Kërkesës për Mbrojtje të Përkohshme, largohet nga shteti, pasuria e konfiskuar mund t'i kthehet (Neni 87 Paragrafi 2 i Ligjit për Azil). Kërkesa për rimbursim duhet të dorëzohet në Sekretariatin Shtetëror për Migracionin para largimit nga shteti.

Dëshmitë mbi prejardhjen e këtyre mjeteve pasurore si dhe kërkesat për kthimin e mjeteve me rastin e largimit nga shteti duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Staatssekretariat für Migration,
Finanzaufsicht, Quellenweg 6,
3003 Bern-Wabern

